

PËR KONKURRUESHMËRINË DHE RRITJEN E AKSESIT NË TREGJE TË PRODUKTEVE JO-USHQIMORE SHQIPTARE ME STANDARDE EVROPIANE

OBJEKTI & METODOLOGJIA



OBJEKTI I VROJTIMIT

- (i) Ndërgjegjësimi i biznesit
- (ii) Aksesit në Informacion
- (iii) Mbështetja Institucionale
- (iv) Sfidat në rrugën drejt standardeve




METODOLOGJIA

- Pyetësor i strukturuar
- Dërguar me email kompanive
- Plotësuar online në mënyrë anonime nga 143 biznese
- Anketa përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës maj-qershor 2024


PROFILI I KAMPIONIT

143 SIPËRMARRJE


Mosha e kompanisë tuaj:




Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj (% totalit):




Forma e organizimit të biznesit tuaj (% totalit):




Aksioneri/Ortaku/Pronari më i madh i biznesit tuaj është:



Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros të vitit të fundit




Numri mesatar i punonjësve




PROFILI I KAMPIONIT

143 SIPËRMARRJE


Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:



A jeni biznes eksportues?



Ku eksportoni kryesisht?



KONKLUSIONE - ANKETIMI

Informimi *dhe* Ndërgjegjësimi / Biznesit

01

Në përgjithësi kompanitë ndihen të pa-informuara mbi legjislacionin e përgjithshëm apo edhe specifik që ka të bëjë me respektimin e standardeve/ rregulloreve teknike/mbikqyrjes së tregut.

02

Kompanitë i konsiderojnë shumë të rëndësishme standardet (9 në 10 kompani) kryesisht Turizmi, Industria dhe Bujqësia.

03

1 në 2 kompani synojnë tregun e BE dhe duan të investojnë në drejtim të rritjes së cilësisë së produkteve që prodhojnë/ tregtojnë.

04

Sfidat kryesore në arritjen e standardeve dhe cilësisë më të lartë lidhen me mungesën e kualifikimit, ekspertizës dhe njohurive mbi standardet dhe përfitimet e tyre, mungesën e mbështetjes institucionale, praktikat kulturore dhe tradicionale dhe kërkesën e pamjaftueshme të tregut për produkte të standardizuara dhe kostot e larta.

KONKLUSIONE - ANKETIMI

AKSESI *në* INFORMACION

01

Kompanitë theksojnë vështirësi në aksesin në informacionin në lidhje me strukturën e cilësisë (3 në 5 kompani).

02

Studio të konsulencës, Ministria e Financës (MF) dhe Interneti konsiderohen burime kryesore të informacionit.

03

1 në 5 kompani e konsiderojnë jo-të qendërzuar informacionin në lidhje me strukturën e cilësisë.

04

Kompanitë gjykojnë nevojën e një portali të vetëm ku të ofrohet informacioni i detajuar dhe koherent mbi vendosjen e produkteve në tregun e brendshëm.

05

Edhe eksportuesit theksojnë nevojën e krijimit të një pike të vetme kontakti në lidhje me informacionin mbi eksportin e produkteve drejt BE.

06

9 në 10 kompani shprehen se mungon dialogu i qëndrueshëm me to në lidhje me certifikatat e konformitetit të produktit.

KONKLUSIONE - ANKETIMI

MBËSHTETJA INSTITUCIONALE

01

Certifikimi krijon sfidat më të mëdha për kompanitë që operojnë në vend, por edhe për ato eksportuese.

02

Kompanitë gjykojnë se u mungon mbështetja institucionale, si nga ana e dhomave/shoqatave të biznesit ashtu edhe nga ana e institucioneve shtetërore.

03

3 në 5 kompani perceptojnë se shteti nuk ofron masa për lehtësim të aksesit në certifikim.

04

2 në 5 kompani perceptojnë mungesën e ndihmës financiare shtetërore në uljen e kostove të përvetësimit të standardeve.

05

Mbështetje financiare në pajisje dhe teknologji vlerësohet si masa kryesore mbështetëse nga ana e shtetit.

06

Kompanitë janë të ndara në lidhje me faktin e ndarjes së kostos me shtetin në lidhje me arritjen e standardeve dhe rregulloreve të BE.

KONKLUSIONE - ANKETIMI

INSPEKTIVE

01

Kompanitë subjekt inspektimesh kanë vërejtur praktika të parregullta nga ana e trupave inspektuese, të cilat kryesisht kanë qenë praktika korruptive dhe shkelje procedurash.

02

Nga kompanitë që kanë qenë objekt vlerësimi të certifikatave të konformitetit, vetëm 2 në 5 kompani deklarojnë se trupat vlerësuese kanë qenë të akredituar.

01

2 në 5 kompani vlerësojnë se dokumentat e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare njihen nga vendet importuese, në masën më të madhe në Bujqësi dhe Industri përpunuese.

02

Në përgjithësi eksportuesit në masë më të madhe (rreth 53%) janë të certifikuar si kompani, në dallim nga kompanitë që operojnë brenda vendit ku vetëm 26% kanë marrë certifikata ISO.

03

Vetëm 1 në 10 kompani ka laboratorë/pajisje teknologjike për kryesrjen e analizave brenda kompanisë dhe 9 në 10 kompani të tilla kanë personelin e aftë për përdorimin e tyre.

04

3 në 10 kompani mendojnë se laboratorët e akredituar në vend janë pak/aspak të besueshëm; 4 në 10 kompani mendojnë se laboratorët janë të besueshëm/shumë të besueshëm.

KONKLUSIONE - ANKETIMI

PROBLEMATIKA TË NJË TREGU KONKURRUES DHE MARKIMI CE

01

MARKIMI CE: Për eksportuesit vështirësitë qëndrojnë në: Kostot e Testimit dhe Mungesën e Njohurive lidhur me certifikimin për markën CE; ndërsa në tregun e brendshëm: Mungesa e Njohurive dhe Mungesa e Stafit të Kualifikuar.

02

4 në 5 kompani e gjykojnë të nevojshme/shumë të nevojshme konsulencën profesionale për të arritur kërkesat e standardeve/rregulloreve të BE-së.

03


Korrupsoni, mungesa e profesionalizmit të administratës shtetërore dhe mungesa e ndërgjegjësimit mbi nivelin e respektimit të standardeve janë problematikat kryesore të listuara nga kompanitë.

INFORMIMI MBI DETYRIMET LIGJORE



Afërsisht 7 në 10 kompani që operojnë kryesisht në industrinë përpunuese, ndërtim dhe tregti nuk kanë informim mbi detyrimet ligjore që burojnë nga ligji 10489/2011 “Për Tregtimin dhe Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve Joushqimore” për operatorët ekonomikë në treg.



A jeni në dijeni mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve që burojnë nga Ligji 10489/2011?



INFORMIMI MBI DETYRIMET LIGJORE

45% e kompanive janë të informuara mbi legjislacionin specifik që aplikohet në veprimtarinë e tyre, më shumë të informuara shfaqen Industria Nxjerrëse, Bujqësia dhe Shërbimi Ushqimor.



A jeni në dijeni mbi kërkesa specifike në legjislacionin në fuqi për produktet e prodhuar/tregtuar sipas aktivitetit tuaj ekonomik (lëndë e parë/të futura në zinxhirin e krijimit të vlerës)?



NDËRGJEGJËSIMI NDAJ STANDARDEVE

Gati 9 në 10 kompani e konsiderojnë shumë të rëndësishëm respektimin e standardeve në produktet që prodhojnë/tregtojnë, kryesisht kompani që operojnë në Turizëm, Industri, TIK dhe Bujqësi

Sa të rëndësishëm e konsideroni respektimin e standardeve të cilësisë në produktet që prodhoni/ tregtoni?




NDËRGJEGJËSIMI NDAJ STANDARDEVE


“Më shume se 1 në 2 kompani synojnë tregun e BE-së dhe duan të investojnë në drejtim të rritjes së cilësisë së produkteve që prodhojnë/tregtojnë; **1 në 5 kompani nuk mund të përballojnë investimin në këtë drejtim**, dhe pjesa tjetër janë të kënaqur me tregtinë brenda vendit ose jashtë BE.

Më të interesuar drejt eksporteve në tregun BE shfaqen aktivitete të Turizmit, Industria përpunuese dhe Bujqësia.

A mendoni të investoni në drejtim të përputhshmërisë me standardet dhe rritjes së cilësisë së produkteve:



Po, sepse dua të futem në një treg me potencial më të madh evropian




SFIDAT: RESPEKTIMI I STANDARDEVE



Sfidat kryesore në arritjen e standardeve dhe cilësisë më të lartë lidhen me mungesën e mbështetjes institucionale, mungesën e kualifikimit, ekspertizës dhe njohurive mbi standardet dhe përfitimet e tyre, kostos së lartë, praktikat kulturore dhe tradicionale dhe kërkesën e pamjaftueshme të tregut për produkte të standardizuara.

Cilat janë disa sfida me të cilat përballen NVM-të shqiptare kur përpiqen të prodhojnë/tregtojnë me standarde?




AKSESI NË INFORMACION



Më shumë se 3 në 5 kompani mendojnë se informacioni mbi infrastrukturën e cilësisë nuk është lehtësisht i aksesueshëm, ndërkohë më pak se 1 në 5 kompani mendojnë se informacioni është lehtësisht i aksesueshëm.

A mendoni se informacioni në lidhje me infrastrukturën e cilësisë së produkteve (rregulloret teknike, standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut) është lehtësisht i aksesueshëm?




INFORMIMI

Institucione përgjegjëse



Afërsisht 1 në 5 kompani gjykojnë se nuk ka një institucion qendror përgjegjës për infrastrukturën e cilësisë.

A e dini nëse ka një institucion të caktuar qeveritar përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të politikave mbi infrastrukturën e cilësisë (rregulloret teknike, standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut)?




INFORMIMI

Institucione përgjegjëse



Studio të konsulencës, Ministria e Financës (MF) dhe Interneti konsiderohen burime kryesore të informacionit në lidhje me strukturën e cilësisë.

Nëse nuk keni informacion ose kërkonti informacionin më të fundit ku drejtoheni fillimisht për marrjen e informacionit:




INFORMIMI


Lehtësia në përdorim

86% e kompanive mendojnë se është i nevojshëm një portal i vetëm ku të jetë vendosur i gjithë informacioni përkatës në lidhje me vendosjen e produkteve në treg.

A ekziston një portal/website i caktuar për NMVM-të ku mund të gjejnë të gjithë informacionin përkatës mbi vendosjen e produkteve në tregun e brendshëm, në lidhje me rregulloret egzistuese/të reja dhe si të respektohen ato kundrejt vlerësimit të konformit?



A gjykoni se një portal i tillë (si më sipër) është i domosdoshëm për operatorët ekonomikë në treg?




INFORMIMI


Lehtësia në përdorim

“Eksportuesit kërkojnë krijimin e një pike të vetme ku mund të gjendet informacioni i përditësuar në lidhje me eksportin në tregun e vetëm të BE.

EKSSPORTUES - A ekziston një portal/website i caktuar për NMVM-të ku mund të gjendet i përditësuar informacioni përkatës në lidhje me eksportin në tregun e vetëm të BE-së?



EKSSPORTUES - A mendoni se një portal i tillë (si më lart) është i domosdoshëm për eksportuesit?




INFORMIMI


Lehtësia në përdorim

“Eksportuesit kërkojnë krijimin e një pike të vetme kontakti në lidhje me informacionin për harmonizimin me kërkesat e tregut të vetëm të BE dhe kjo duhet të vendoset tek dhomat e tregtisë/shoqatat e biznesit.

EKSPORTUES - A gjykoni se duhet të krijohet një pikë e vetme kombëtare si kontakt (Helpdesk) për eksportuesit në lidhje me informacionin për harmonizimin me kërkesat e tregut të vetëm të BE-së:




Nëse po, ku mund të vendoset:





93% e kompanive nuk kanë marrë pjesë në forume mbi dialogun në lidhje me sfidat për certifikatat e konformitetit.

A keni marrë pjesë në forume në baza të rregullta për dialogun ndërmjet organizatave kombëtare të standardeve (NSO) dhe shoqatave të biznesit që përfaqësojnë NMVM-të në lidhje me sfidat për certifikatat e konformitetit (testimin, inspektim, certifikim)?




BESUESHMËRIA E PRODUKTIT



**Certifikimet
krijojnë më
shumë sfida si
për tregun
vendas ashtu
edhe për
eksportuesit,
madje për
eksportuesit në
një përqindje
më të lartë.**


Në përpjekjet tuaja, ku keni pasur më shumë sfida në lidhje me besueshmërinë e produktit tuaj:





**Dhomat/Shoqat
at e biznesit
nuk ofrojnë
informacion
të përditësuar**
në lidhje me
infrastrukturën e
cilësisë, bazuar
në gjykimin e
kompanive
(afërsisht 7 në 10
kompani).

A ju ofrojnë dhomat e tregtisë/shoqatat e biznesit informacion të përditësuar (p.sh. buletinet) për detyrime që lidhen me infrastrukturën e cilësisë, standardet dhe aktivitetet e standardizimit?




MBËSHTETJA INSTITUCIONALE



Më shumë se 3 në 10 kompani vlerësojnë se shteti nuk ofron masa për lehtësim të aksesit në certifikim dhe 3 në 5 kompani nuk shfaqen të interesuara nëse shteti ofron të tilla masa (përgjigja: nuk e di)


A ofron shteti masa (këshillim, etj.) për të lehtësuar aksesin e NMVM-ve për të certifikuar produktet/shërbimet e tyre?





38% e kompanive vlerësojnë mungesën e ndihmës financiare shtetërore në uljen e kostove të përvetësimit të standardeve, ndërkohë 48% e tyre nuk janë të interesuar (përgjigja: nuk e di)

A ka ndonjë masë financiare shtetërore (p.sh. subvencione) që ul koston e përvetësimit të standardeve për NMVM-të?




MBËSHTETJA INSTITUCIONALE



**Mbështetje
financiare në
pajisje dhe
teknologji
vlerësohet si
masa kryesore
mbështetëse
nga ana e
shtetit.**

Në opinionin tuaj, çfarë hapash mund të ndërmarrë qeveria shqiptare për të mbështetur NVM-të në prodhimin dhe tregtimin e produkteve që plotësojnë standardet ndërkombëtare?




MBËSHTETJA INSTITUCIONALE



Kompanitë janë të ndara në lidhje me faktin e ndarjes së kostos me shtetin në lidhje me arritjen e standardeve dhe rregulloreve të BE-së.


Për te arritur kërkesat e standardeve apo rregulloreve të brendshme apo të BE-së do të ishit të gatshëm të ndanit kostot përkatëse me shtetin?




INSPEKTIVE

“ 7 në 10 kompani kanë qenë objekt inspektimesh, ku afërsisht 2 në 5 kompani kanë vërejtur praktika të parregullta të inspektorëve, kryesisht praktika korruptive dhe shkelje procedurash.


A keni qene objekt i inspektimeve nga trupat inspektuese shtetërore?



Keni konstatuar praktika të parregullta nga ana e inspektorateve shtetërore?




Praktikat e parregullta nga ana e inspektorateve shtetërore kanë qenë kryesisht lidhur me:




INSPEKTIVE

Vetëm 34% e kompanive kanë qenë objekt i vlerësimit të konformitetit dhe 41% vlerësojnë se organet përkatëse kanë qenë të akredituara.

A jeni objekt i procedurave të vlerësimit të konformitetit (testime, certifikime, inspektive) në lidhje me plotësimin e kërkesave të detyrueshme tekniko-ligjore, aplikimin e standardeve të harmonizuara për lëshimin e certifikatave të konformitetit?




A kanë qenë të akredituar organet përkatëse të vlerësimit të konformitetit?





36% vlerësojnë se dokumentat e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare njihen nga vendet importuese, në masën më të madhe në Bujqësi dhe Industri Përpunuese.

Nëse eksportoni, a njihen dokumentet e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare të vlerësimit të konformitetit?




CERTIFIKIMI



Në përgjithësi eksportuesit në masë më të madhe (rreth 53%) janë të certifikuar si kompani, në dallim nga kompanitë që operojnë brenda vendit ku vetëm 26% kanë marrë certifikata ISO.


A jeni certifikuar si kompani kundrejt kërkesave të standardeve ISO?




TEKNOLOGJIA MBI STANDARDET

“ Vetëm 1 në 10 kompani ka laboratorë/pajisje teknologjike për kryerjen e analizave brenda kompanisë dhe 9 në 10 kompani të tilla kanë personelin e aftë për përdorimin e tyre.

Në lidhje me vlerësimin e konformitetit të produktit tuaj, a keni laborator/pajisje teknologjike për kryerjen e analizave brenda kompanisë tuaj?



A keni personel të aftë për kryerjen e analizave brenda kompanisë tuaj?




LABORATORË TË AKREDITUAR NË VEND



3 në 10 kompani mendojnë se laboratorët e akredituar në vend janë pak/aspak të besueshëm; 4 në 10 kompani mendojnë se laboratorët janë të besueshëm/shumë të besueshëm.

Bazuar në eksperiencën tuaj vlerësoni ndërveprimin me laboratorët e akredituar në vend në lidhje me besueshmërinë e rezultateve:





MARKIMI CE



Për eksportuesit vështirësitë qëndrojnë në: Kostot e Testimit dhe Mungesën e Njohurive lidhur me certifikimin për markën CE; ndërsa në tregun e brendshëm: Mungesa e Njohurive dhe Mungesa e Stafit të Kualifikuar.

Në vijim të synimit për të adoptuar së shpejti legjislacionin e BE-së në Shqipëri, nëse produkti juaj do të ishte subjekt i certifikimit me markën CE, ku do t'i shikoni vështirësitë për të kryer dhe mirëmbajtur këtë certifikim - **Tregu brendshëm**

Në vijim të synimit për të adoptuar së shpejti legjislacionin e BE-së në Shqipëri, nëse produkti juaj do të ishte subjekt i certifikimit me markën CE, ku do t'i shikoni vështirësitë për të kryer dhe mirëmbajtur këtë certifikim - **Eksportues**




NEVOJA PËR KONSULENTË



**4 në 5 kompani e
gjykojnë të
nevojshme/shumë të
nevojshme
konsulencën
profesionale** për të
arritur kërkesat e
standardeve /
rregulloreve të BE-së.

Për të arritur kërkesat e standardeve apo rregulloreve të brendshme apo të BE-sa sa të nevojshme e vlerësoni marrjen e njohurive dhe të konsulencës profesionale:




NEVOJA PËR KONSULENTË



**4 në 5 kompani e
gjykojnë të
nevojshme/shumë të
nevojshme
konsulencën
profesionale** për të
arritur kërkesat e
standardeve /
rregulloreve të BE-së.

Për të arritur kërkesat e standardeve apo rregulloreve të brendshme apo të BE-sa sa të nevojshme e vlerësoni marrjen e njohurive dhe të konsulencës profesionale:



RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula


Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbatjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council

 ALInvestCouncil

 Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).